



Nr. 194/12 Prot.
Datë, më 09.10.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 19109 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 74, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE
“BEQIR ÇELA” DURRËS

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”;

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 8 datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, **Akreditim me kusht** me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023.
2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas vendimit nr. 8, datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për kualifikimet profesionale si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Shërbim mjeteve transporti” | Niveli II në KSHK, M-II-17 |
| 2. “Shërbime motorike” | Niveli III në KSHK, M1-III-18 |
| 3. “Shërbime xhenerike” | Niveli III në KSHK, M2-III-18 |
| 4. “Shërbime elektroauto” | Niveli III në KSHK, M3-III-18 |
| 5. “Shërbim mjeteve transporti” | Niveli IV në KSHK, M-IV-15 |
| 6. “Mekanike” | Niveli II në KSHK, F-II-17 |

- | | |
|--|-------------------------------|
| 7. “Elektroteknikë” | Niveli II në KSHK, E-II-17 |
| 8. “Instalim elektrik civil dhe industrial” | Niveli III në KSHK, E1-III-18 |
| 9. “Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake” | Niveli III në KSHK, E2-III-19 |
| 10. “Elektromekanikë” | Niveli III në KSHK, E4-III-19 |
| 11. “Elektroteknikë” | Niveli IV në KSHK, E-IV-21 |
| 12. “Teknologji informacioni dhe komunikimi” | Niveli II në KSHK, T-II-19 |
| 13. “Mbështetje e përdoruesve të TIK” | Niveli IV në KSHK, T2-IV-21 |
| 14. “Zhvillim website” | Niveli IV në KSHK, T3-IV-21 |

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1; shkronja a) e nenit 18, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës, do t’i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësimin të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

